



Projekti i Reformës në Administratën Publike– Shqipëri

Shërbime Këshillimore për të përmirësuar Funkcionet Publike të

Institucioneve qendrore

Raport mbi strukturën funksionale të

Ministrisë së Integritit European

Prill 2006

Përmbajtja e lëndës

Shënim	iii
Fletë përmbledhëse e projektit.....	iv
Përmbledhje e propozimeve tona për Ministrinë e Integritit Europian.....	v
1.0 Hyrje.....	1
2.0 Informacion i përgjithshëm	1
2.1 Roli i Ministrive të tjera dhe Agjencive Qendrore	1
2.1.1 Përgjegjësitë funksionale të Drejtorisë së Koordinimit të Strategjive dhe të Donatorëve në Këshillin e Ministrave.....	2
3.0 Misioni i Ministrisë së Integritit Europian	4
4.0 Struktura e mëparshme e Ministrisë së Integritit Europian	5
4.1 Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit	5
4.1.1 Sektori i Koordinimit.....	5
4.1.2 Sektori i Çertifikimit.....	6
4.1.3 Sektori i Dokumentacionit Europian.....	7
4.1.4 Sektori i përkthimit.....	7
4.2 Drejtoria e Integritit Europian	7
4.2.1 Sektori i Çështjeve të Drejtësisë dhe të punëve të brendshme	8
4.2.2 Sektori i Çështjeve Ekonomike e Sociale	8
4.2.3 Sektori i Asistencës së Komunitetit.....	8
4.2.4 Sektori i Analizave dhe Publikimeve	9
5.0 Natyra e problemeve të identifikuar.....	9
6.0 Vlerësimi i Strukturës Ekzistuese	13
6.1 Drejtoritë koordinuese.....	13
6.2 Drejtoria e proceseve institucionale të Koordinimit & Integritit	16
6.2.1 Bashkëpunimi rajonal / Informimi i publikut	16
6.2.2 Metodologjia e raportimit & Përkthimet.....	16
6.3 Instrumentat e para-pranimit.....	18

7.0	Modele të Strukturave Funktionale të vendeve të tjera	19
7.0.1	Malta.....	19
7.0.2	Rumania	20
7.0.3	Kroacia	20
7.0.4	Konsiderata për Shqipërinë	21
8.0	Struktura funksionale e propozuar	22
8.1	Drejtoria e Koordinimit dhe Analizës.....	22
8.1.1	Koordinimi	22
8.1.2	Raportimi	23
8.1.3	Monitorimi.....	23
8.1.4	Analiza.....	24
8.2	Drejtoria e Asistencës për pranimin & informimit të komunitetit.....	24
8.2.1	Asistenca e pranimit	25
8.2.2	Shpërndarja e informacionit.....	26
8.2.3	Bashkëpunimi rajonal	26
8.3	Drejtoria e çertifikimeve	27
8.3.1	Çertifikimi i legjislacionit.....	27
8.3.2	Çertifikimi i përkthimeve	28
8.4	Shërbimet mbështetëse.....	28
9.0	Në lidhje me Ministrinë e Linjës.....	28
10.0	Shënim përmbyllës.....	29

Shënim

Ky raport është një dokument që do t'i nënshtrohet shqyrtimit nga të gjitha palët pjesëmarrëse në këtë projekt dhe si i tillë nuk paraqet opinionet apo konkluzionet tona përfundimtare. Në këtë raport janë përfshirë të gjitha komentet gojore të bëra gjatë diskutimeve me persona të ndryshëm në këtë ministri.

Ky raport nuk ka për qëllim të ndryshojë dukshëm angazhimet e shprehura në propozimin tonë: por ky dokument duhet parë si një sqarim i çështjeve të diskutuara në propozim.

Qëllimi i projektit është ristrukturimi funksional në atë masë që do të kërkohet. Ky projekt nuk është një iniciativë, e cila synon t'u tregojë nëpunësve të administratës publike se si duhet të kryejnë detyrat e përditshme, apo të bëjë propozime për të përmirësuar performancën e këtyre detyrave nëpërmjet procedurave më efikase dhe përdorimit të teknologjisë së informacionit. Në këtë iniciativë nuk është problem kryesor reduktimi i kostos. Në përfundim, duhet kuptuar që fokusi i projektit është në grupimin funksional e jo procesi i përmbushjes së detyrave, i cili do të kërkonte një shqyrtim më në thellësi të operacioneve specifike. Dihet që një rregullim funksional më efektiv do të çojë edhe në mundësi të uljes së kostos. Megjithatë, nuk është në termat e këtij projekti identifikimi i mënyrave të reduktimit të kostos dhe si të veprohet me to.

Fletë përmbledhëse e projektit

Titulli i projektit:	Shërbime konsulence për përmirësimin e funksioneve publike të institucioneve qendrore
Sponsor:	Banka Botërore
Vendi:	Republika e Shqipërisë
Objektivi i projektit:	<p>Objektivi kryesor i këtij projekti është kryerja e analizës funksionale e organizative të organizmave të administratës qendrore të qeverisë Shqiptare, nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përcaktimit të funksioneve kryesore të qeverisë me anë të riformulimit dhe racionalizimit të roleve, misioneve, objektivave strategjikë, funksioneve, strukturave organizative dhe rezultatet e pritshme të institucioneve të sistemit të ministrive; • Identifikimit të funksioneve të tepërta e të mbivendosura në institucionet në shqyrtim e midis tyre dhe identifikimi i atyre njësive të administratës publike që duhen ruajtur, transferuar, deleguar tek organizma të tjerë më të përshtatshëm, eliminuar apo ndarë; • Fuqizimi i kapaciteteve të Departmentit të Administratës Publike për ta aftësuar atë të kryejë analiza funksionale të mëtejshme.
Qëllimi i projektit:	Grupimi i aktiviteteve aktuale e atyre ekzistuese në funksione të ndara dhe t'i "filtru" ato në funksione potencialisht të tepërta, të transferueshme, racionalizuara apo të privatizueshme në bazë të kriterëve të rëna dakord.
Zonat e ndërhyrjes dhe rezultatet e planifikuara:	<p>Ndërgjegjësimi i stafit drejtues për misionin dhe qëllimet strategjike të organizatave të tyre dhe si duhen strukturuar ato për të shërbyer në arritjen e objektivave të tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Struktura më të mëdha menaxhuese. • Kapacitete më të mëdha menaxhuese. • Kredibiliteti i administratës publike më i madh. • Kapacitetet profesionale të stafit të DAP më të rritura.
Rezultatet e projektit:	<ul style="list-style-type: none"> • Analiza e situatës së Reformës së Administratës Publike në Shqipëri. • Analiza Funksionale e institucioneve në 17 ministritë ekzistuese. • Raporte që identifikojnë nëse funksionet e njësive nevojiten apo janë të tepërta dhe rekomandimet nëse këto funksione duhen konsoliduar, transferuar, racionalizuar apo privatizuar.
Aktivitetet e projektit:	<ul style="list-style-type: none"> • Shqyrtimi diagnostik i mjedisit institucional duke u fokusuar në Misionet, objektivat dhe përgjegjësitë funksionale; • Asistencë teknike dhe mbështetje për DAP, për grupet e analizës funksionale në të gjitha ministritë, për vendimmarrësit dhe ekzekutivët e ministrive. • Ndërgjegjësimi i publikut për Reformën në Administratën Publike. • Organizimi dhe menaxhimi i seminareve në vend si dhe udhëtimeve studimore jashtë shtetit. • Nxitja e krijimit të besimit dhe transferimi i shprehive.
Filimi i projektit:	Shkurt 2005
Zgjatja e projektit:	17 muaj

Përmbledhje e propozimeve tona për Ministrinë e Integrimit Europian

Duhet marrë në konsideratë adoptimi i propozimeve të mëposhtme:

Misioni

Deklaratat e misionit duhet të jenë të shkurtra dhe të shmangin shprehjet e mekanizmave (qasjet dhe proceset e përdorura për të dhënë shërbimin): propozojmë që ajo të shprehet më thjesht si:

Drejtimi teknik dhe bashkërendimi i procesit të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian

Duhet krijuar një skemë e menaxhimit të performancës, e cila, ndër të tjera, do të përcaktojë synimet e performancës për të plotësuar kërkesat e përgatitjes për integrim në BE.

Struktura e Ministrisë

Propozojmë një strukturë në të cilën do të ketë 4 drejtori që raportojnë tek Sekretari i Përgjithshëm: Drejtorja e Koordinimit & Analizës; Drejtorja e Asistencës së pranimit & Informimit të Komunitetit; Drejtorja e Çertifikimit dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse.

Në vend të ndarjes së Drejtorisë për Përafrimin e Legjislacionit në Drejtori përgjegjëse për koordinimin e Ministrive Sektoriale, do të propozonim forcimin e kësaj drejtorie.

Propozojmë që Drejtorja e Çështjeve të Drejtësisë dhe atyre të Brendshme si dhe Drejtorja e Tregut të Brendshëm të ribashkohet, por me detyra më të ngushta si koordinimi, raportimi dhe monitorimi i ministrive për përpjekjet e tyre të pranimit dhe kryerja e analizave.

Në afat të shkurtër, përpara se të krijohet rrjeti rajonal (Informimi i Bashkimit Europian), do të ishte e preferueshme për Ministrinë të krijonte njësinë e vet të Dokumentimit dhe Informimit të publikut për të krijuar një Qendër të përqëndruar informimi mbi BE, që të funksionojë në mënyrë eficiente dhe efektive e më pas të zgjerohet gjeografikisht.

Duhet krijuar një sistem i përqëndruar ku të përgatiten përkthimet dhe të çertifikohen ato përpara se të fillojë puna dhe pasi të jenë përfunduar përafrimet.

Duhet hartuar një “fjalor” përkthimi me fjalët kryesore ose ato që ndeshen më shpesh.

Propozojmë një Drejtori Çertifikimi, që të ketë përgjegjësinë për çertifikimin e përkthimeve të dokumentave dhe të çertifikimeve të përafrimit të legjislacionit.

Transaksionet e Ministrisë janë të tilla që nuk shtrojnë nevojën e një funksioni të përhershëm të Auditimit të Brendshëm: herë pas here, Sekretari i Përgjithshëm/Ministri duhet të kërkojë që këto shërbime t'i marrë nga një ministri tjetër.

Ministritë e Linjës

Propozojmë që Sekretarët e Përgjithshëm në ministritë e linjës duhet të lejohet të kenë një Sekretariat të vogël joekzekutiv me një deri në tre persona: përgjegjësia e këtij sekretariati nuk do të jetë e lidhur vetëm me çështjet që lidhen me integrimin Europian, por ai gjithashtu do të veprojë për të siguruar që detyrat që lidhen me Drejtoritë në varësi të kryhen me kompetencë.

* * * * *

Sa më sipër përmbledh propozimet tona për Ministrinë e Integritit Europian. Për të marrë në konsideratë këto propozime në kontekstin e tyre, duhet t'i referoheni raportit në vijim.

1.0 Hyrje

Ky raport trajton organizimin funksional të Ministrisë së Integrimit European ashtu siç është aprovuar zyrtarisht në Mars 1996. Qëllimi ynë është të shqyrtojmë qëllimin e ministrisë dhe masën në të cilën rregullimi aktual funksional është i suksesshëm për të çuar përpara objektivin e politikës së qeverisë për anëtarësimin në Bashkimin European.

2.0 Informacion i përgjithshëm

Bazuar në VKM Nr. 580 të datës 10 / 09 / 2004 ‘ Për fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Integrimit European’, Ministria, ndër të tjera, është përgjegjëse për sa më poshtë:

- Bashkërendon punën dhe monitoron përgatitjet e institucioneve shqiptare dhe angazhimet e ndërmarra prej tyre, në kuadër të procesit të Stabilizim-Asociimit;
- Bashkërendon punën ndërmjet ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera qendrore për hartimin e planeve kombëtare për Partneritetin European, me qëllim realizimin e objektivave të përcaktuara në kuadër të procesit të integrimit european;
- Bashkërendon punën dhe ndihmon ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore për hartimin e legjislacionit të nevojshëm në përputhje me *Acquis Communautaire*, me qëllim përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asociimit;
- Përgatit mekanizmat metodologjikë në funksion të lehtësimit të zbatimit të reformave sektorale, që rrjedhin nga negociimi dhe zbatimi i marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- Drejton dhe bashkërendon programet e bashkëpunimit kombëtar dhe rajonal midis BE-së dhe Shqipërisë.

2.1 Roli i Ministrive të tjera dhe Agjencive Qendrore

Si një zgjerim i sa më sipër dhe për qartësuar përgjegjësitë e institucioneve të tjera, Vendimi Nr. 317, datë 13.05.05, ‘Mbi aprovimin e Planit Kombëtar për Përfarimin e Legjislacionit me *ACQUIS* e BE-së dhe Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit’, ndër të tjera, thotë:

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore në varësi të Këshillit të Ministrave do t'i raportojnë Ministrit të Integrimit European në fillim të çdo tre mujori në lidhje me përmbushjen e detyrave që rrjedhin nga Plani Kombëtar për Përfarimin e Legjislacionit me *Acquis* e BE-së dhe zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe përmbushjen e detyrave të parashikuara në VKM Nr. 634 të datës

30.08.2004 'Mbi aprovimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve të Partneritetit Europian”.

Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi ministritë dhe institucionet e tjera qendrore janë të ngarkuara të dorëzojnë propozimet e tyre tek:

- a) Ministria e Financës dhe Departamenti i Administratës Publike në lidhje me shtesat dhe ndryshimet në burimet njerëzore në përputhje me objektivat e parashikuara në këtë plan kombëtar, i cili do të jetë subjekt analize dhe aprovimi nga këto institucione.
- b) Ministria e Financave për mjetet financiare të nevojshme për zbatimin e masave afatshkurtra të parashikuara në Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit me *Acquis* e BE-së dhe zbatimin e Marëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Sa më sipër, ashtu siç shprehet e nënkuptohet, shërben për të bërë të qartë që çdo ministri është përgjegjëse për të plotësuar detyrimet e saj për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian. Kjo bën gjithashtu të qartë që Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike do të përcaktojë burimet e çdo ministrie.

2.1.1 Përgjegjësitë funksionale të Drejtorisë së Koordinimit të Strategjive dhe të Donatorëve në Këshillin e Ministrave

Në mënyrë që të caktohen siç duhet përgjegjësitë funksionale të Ministrisë së Integritit Europian, mendojmë që është e rëndësishme të përcaktojmë rolin e njësisë përgjegjëse për koordinimin e asistencës së ofruar nga donatorët ndërkombëtarë.

Në materialet që propozojnë krijimin e Drejtorisë së Koordinimit të Strategjive dhe Donatorëve, midis të tjerave, janë propozuar funksionet e mëposhtme:

- Mbikqyrja dhe bashkërendimi për hartimin dhe zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPS) si pjesë e një programi më të madh për modernizimin e qeverisë;
- Sigurimi i cilësisë, koherencës dhe bashkërendimit efektiv të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Social-Ekonomik (SKZhES); dhe
- Maksimizimi i kontributit të asistencës së jashtme për arritjen e prioriteteve të politikës kombëtare.

Mbështetur në sa më sipër, nën-përgjegjësitë e Drejtorisë së Koordinimit të Strategjive dhe donatorëve janë të:

- organizojnë sesione pune periodike me institucionet e tjera qendrore për të siguruar që produktet e tyre të lidhura me IPS-në janë plotësisht të

harmonizuara dhe nuk dublojnë apo shtrojnë kërkesa të panevojshme për ministritë.

- punojnë të lidhura ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Ministrinë e Integritit European për të siguruar që proceset e përgatitjes së buxhetit afatmesëm (MTBP) dhe integritit European reflektojnë qëllimet dhe objektivat e SKZhES.
- jenë një pikë e vetme kontakti për donatorët në lidhje me çështjet strategjike që lidhen me asistencën e jashtme; me synimin për të optimizuar përputhjen midis prioriteteve të asistencës së jashtme për qeverinë dhe programet e donatorëve multi/bilaterale/instrumentave të ndihmës.
- Në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Integritit European dhe zyrën e Sekretariatit Teknik të Donatorëve (STD) hartojnë dhe mbikqyrin një asistencë të jashtme të gjithanshme për Sistemet e menaxhimit të Informacionit MIS / FMIS bazuar në informacionin e dhënë nga qeveria apo nga donatorët.

Është e qartë nga sa më sipër që koordinimi i asistencës së donatorëve ndërkombëtarë është një aktivitet që duhet ndjekur nga një Departament brenda Këshillit të Ministrave, i krijuar specifikisht për këtë qëllim. Për këtë përgjegjësi, Drejtoria e Koordinimit të Strategjive dhe Donatorëve në KM duhet të konsultohet edhe me Ministrinë e Integritit European, midis të tjerave.

Më poshtë kthehemi në diskutimin e Ministrisë së Integritit European dhe funksionalitetit të saj.

3.0 Misioni i Ministrisë së Integritit European

Ministria e Integritit European ka për mision drejtimin teknik dhe bashkërendimin e procesit të integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit European, hartimit të politikave të integritit, bashkërendimit të ndihmave financiare dhe informimit të publikut për këtë proces.

Në përputhje me parimin tonë udhëheqës që deklaratat e misionit duhet të jenë të shkurtra dhe të shmangin shprehjet e mekanizmave (qasjet dhe proceset e përdorura për të arritur misionin), propozojmë të fshijmë pjesën e dytë të kësaj deklarate. Kemi mendimin që fjalia e parë në deklaratën e mësipërme është Misioni operativ:

Të jepet drejtim teknik dhe të bashkërendohet procesi i integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European

Një çështje lidhur me këtë Ministri dhe procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin European është nëse Ministria shërben si një lokomotivë apo lehtësues i synimit të vendit për t'u integruar në Bashkimin European, dmth një forcë drejtuese apo koordinator i përpjekjeve të ministrive të tjera. Pikëpamja jonë është që *Ministri* shërben si forca kryesore drejtuese, ndërsa *Ministria* është koordinuese, siguron që ministrinë e tjera përmbushin angazhimet e tyre në lidhje me procesin e integritit dhe kërkesat e tij. Këto përgjegjësi (lokomotiva dhe koordinuesi) i konsiderojmë komplementare, por gjithashtu që kërkojnë një dorë shumë të fuqishme. Përveç rasteve të një kolegjaliteti dhe marrëdhënieje miqësore maksimale, është e vështirë të përfytyrohet se si një ministri dhe një ministër në të njëjtin nivel si ministrat dhe ministrinë e tjera të ushtrorë influencë mbi ministrat apo organizatat e këtij niveli. Organizimi aktual mund të ketë sukses pjesërisht dhe vetëm pas një periudhë të gjatë kohe, me shumë ndërhyrje nga Kryeministri.

Jemi të ndërgjegjshëm që të tjerët mbrojnë idenë që Ministria e IE duhet të “gjejë e të shajë” ministrinë që nuk përmbushin detyrimet ligjore, si një qasje që i detyron ministrinë për t'u marrë me përgjegjësitë e tyre. Mendojmë që fajësimi i ministrive në raportet që dërgohen në BE, nuk bën gjë tjetër veçse fajëson Qeverinë e Shqipërisë, e cila tregon që nuk është në gjendje t'i bëjë ministrinë të punojnë siç duhet. Mendojmë që problemet duhen trajtuar e zgjidhur atëhere kur dalin – dhe që raportet për BE-në duhet të jenë raporte “progresi” dhe jo “dështimesh”.

Sipas pikëpamjes sonë, pa ndërhyrjet e domosdoshme e të shpeshta nga Kryeministri, çdo dështim apo thyerje nga ministrinë në përgjigjen e tyre dhe plotësimin e detyrave të tyre do të kërkojë ose ngritjen e autoritetit të Ministrit të Integritit European ose futjen e një skeme serioze të menaxhimit të performancës në të gjithë qeverinë. Gjithashtu, besojmë që një skemë e tillë do

të vendosë përveç të tjerave synime performance për plotësimin e kërkesave për t'u përgatitur për integrimin në BE.

4.0 Struktura e mëparshme e Ministrisë së Integritit European

Përpara ndryshimit të qeverisë në korrik 2005, Ministria funksiononte me një strukturë brenda së cilës ishin 3 drejtori kryesore: Drejtoria e përfarimit të legjislacionit, Drejtoria e Integritit European dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme. Normalisht, meqënëse kjo strukturë që atëhere ka ndryshuar, nuk do ta diskutojmë më atë dhe funksionalitetin e saj. Megjithatë, na është pranuar, që pavarësisht nga ndryshimi zyrtar në strukturë, Ministria deri tani vazhdon të operojë me strukturën e vjetër. Një arsye tjetër është që megjithëse ministria është në tranzicion nga një strukturë e vjetër në një më të re të aprovuar, mbase ka mësimë që ia vlen të nxirren nga një analizë e strukturës së mëparshme dhe caktimi i funksioneve në të.

Përgjegjësitë funksionale të treguara këtu më poshtë janë nxjerrë nga Plani Kombëtar i Përafrimit të legjislacionit dhe Zbatimi i Marëveshjes së Stabilizim Asocijimit, faqe 36 deri 41.

Në këtë seksion të raportit, kemi nënvizuar disa fjalë dhe i kemi dhënë ato me shkronja të zeza për të tërhequr vëmendjen, sepse kjo do të shërbejë për të vënë në pah gamën e funksioneve dhe për të theksuar fushat në të cilat mendojmë që funksionaliteti i Drejtorive dhe Sektorëve mund të kompromentohet apo, së paku, mund të vështirësohet.

4.1 Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit

Drejtorja e Përafrimit të Legjislacionit, në emër të Ministrisë së Integritit European, ka qënë njësi e autorizuar për të çertifikuar që legjislacioni është përafuar në mënyrë korrekte. Mund të paraqiten argumente për të ndryshuar njësinë përgjegjëse, por duhet të ketë një autoritet që të vërtetojë punën që është bërë.

Kjo drejtori kishte 4 sektorë: përgjegjësia e saj funksionale ishte koordinimi i procesit të përafrimit të sistemit ligjor të Republikës së Shqipërisë me sistemin ligjor të BE-së, si dhe me angazhimet ligjore të ndërmarra në kuadër të procesit të Stabilizim Asocijimit. Këtu ndoshta duhet të theksojmë që përgjegjësia zyrtare e saj ishte në lidhje me sistemin ligjor: disa nga përgjegjësitë e caktuara janë shmangur nga fokusi specifik.

4.1.1 Sektori i Koordinimit

- Drejton dhe **bashkërendon** punën për përgatitjen e **Planit Kombëtar** për përafrimin e Legjislacionit dhe Zbatimin e Marëveshjes së Stabilizim Asocijimit (MSA)

- **Bashkërendon dhe monitoron** aktivitetet e grupeve speciale të punës të krijuar për të zbatuar Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit (PKPL) dhe zbatimin e MSA.
- Bashkërendon dhe monitoron aktivitetet e Ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera qendrore dhe **përgatit mekanizmat metodologjike** brenda kuadrit të grupeve speciale të punës për hartimin e legjislacionit të nevojshëm për të plotësuar detyrimet që dalin nga MSA.
- Kontribuon për **zhvillimin e aftësive profesionale** të juristëve, nëpunësve civilë dhe gjykatësve në lidhje me njohuritë për legjislacionin kombëtar të përputhur me legjislacionin e BE-së.
- **Bashkërendon** aktivitetet e Ministrive të Linjës, institucioneve të tjera qendrore dhe grupeve speciale të punës në lidhje me mbështetjen e dhënë nga **asistenca e huaj** për përafrimin e legjislacionit.
- Mban kontaktet dhe bashkëpunon me strukturat e BE-së, në **bashkëpunim** me Sektorin e Çertifikimit për të **identifikuar fushat prioritare** të përafrimit të legjislacionit dhe për t'i **komunikuar** ligjet dhe amendamentet e reja strukturave përkatëse në BE.
- Merr pjesë, në **bashkëpunim** me Sektorin e Çertifikimit në procesin e **përafrimit** të legjislacionit.
- Mban dhe qarkullon informacionin mbi bazën e të dhënave të legjislacionit shqiptar dhe legjislacionin korrespondues të BE-së dhe **shpërndan** informacionin e dhënë nga Bashkimi Europian në lidhje me procesin e përafrimit të legjislacionit.

4.1.2 *Spektori i Çertifikimit*

- Vlerëson përputhjen e projekt akteve normative të propozuara nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore me legjislacionin e BE-së, në përputhje me nivelin e përafrimit që kërkohet.
- Mban database-in e TAIEX (grumbullon dhe fut të dhënat në lidhje me situatën e legjislacionit kombëtar të përputhur me legjislacionin e BE-së dhe ia dërgon ato TAIEX)
- Në **bashkëpunim** me Sektorin e Koordinimit, drejton përgatitjen e **Planit Kombëtar** për Përafrimin e Legjislacionit dhe Zbatimin e MSA.
- Përcakton teknikën dhe **metodologjinë** për përafrimin e legjislacionit
- Bën **analizën krahasuese** midis legjislacionit shqiptar dhe *Acquis Communautaire*
- Mbështet aktivisht Sektorin e Koordinimit në lidhje me përgatitjen e legjislacionit nga grupet e punës të ngritur posaçërisht për këtë qëllim.
- Kontribuon në përgatitjen e **pozicioneve negociatore** në kuadër të takimeve të përbashkëta Shqipëri – Bashkim Europian

- Kontribuon në **përmirësimin e kualifikimit** të juristëve, nëpunësve civilë dhe gjykatësve në lidhje me legjislacionin kombëtar që do të përputhet me atë të BE-së.

4.1.3 *Sektori i Dokumentacionit Europian*

- **Informon** publikun mbi çështjet e integritit Europian, duke ofruar informacion në kohën e duhur mbi aspektet specifike të këtij procesi.
- Është përgjegjës për **zbatimin** e **Strategjisë** së Informimit të Publikut të aprovuar nga Ministri i Integritit Europian.
- **Menaxhon** Qendrën e Dokumentacionit Europian si pjesë të rrjetit të informacionit të Komisionit Europian që përfshin bazën publike të të dhënave të Komisionit Europian.
- **Mban bibliotekën** dhe përpiqet të pasurojë librat dhe publikimet kushtuar Bashkimit Europian, të cilat mbulojnë kryesisht çështjet ligjore dhe menaxhojnë dokumentacionin që merret me procesin e integritit europian, që përfshijnë Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane dhe Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
- Mban marrëdhëniet me strukturat përkatëse të BE-së për të **grumbulluar** informacion për aktivitetet e tyre.
- **Boton** fletëpalosje, broshura, raporte dhe libra mbi çështjet e integritit Europian
- Mbështet, nga pikëpamja **metodologjike**, Ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera që janë të interesuara të grumbullojnë dhe menaxhojnë vetë dokumentacione të BE-së në fushën e veprimtarisë së tyre.

4.1.4 *Sektori i përkthimit*

- Koordinon punën dhe vërteton përkthimin e dokumentave në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së.
- Siguron përkthimin e legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët zyrtare të BE-së në fushat prioritare dhe /ose me kërkesë të strukturave përkatëse të BE-së dhe përpunon standardet për to
- Jep mbështetje terminologjike në lidhje me procesin e përkthimit

4.2 ***Drejtoria e Integritit Europian***

Përgjegjësia e kësaj drejtorie ishte të koordinonte dhe monitoronte procesin e integritit nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- Përgatitja e raundeve të negociimit dhe takimeve të ndryshme Shqipëri – BE

- Monitorimi i plotësimi të detyrimeve që rezultojnë nga procesi i integritit Europian
- Koordinimi, programimi dhe monitorimi i mbështetjes financiare të Bashkimit Europian
- Përgatitja e studimeve analitike për përafrimin e politikave shqiptare me politikat e Bashkimit Europian

Drejtoria konsistonte në 4 sektorë .

4.2.1 *Sektori i Çështjeve të Drejtësisë dhe të punëve të brendshme*

- Koordinon zhvillimin e bisedimeve me BE-në për çështjet që lidhen me Drejtësinë dhe punët e brendshme
- **Analizon** të drejtat dhe detyrimet e palës shqiptare që rrjedhin nga MSA.
- Vlerëson, përpunon dhe **komunikon materialet** e përgatitura nga pala shqiptare në kuadër të bisedimeve
- Vlerëson, përpunon dhe **komunikon materialet** e përgatitura nga pala shqiptare në kuadër të Grupit Këshillimor të Punës, Grupit të Punës dhe takimeve të Komitetit të Përbashkët në mënyrë që të monitorohet zbatimi i reformave që lidhen me procesin e integritit Europian
- Monitoron zbatimin e reformave që rezultojnë nga MSA

4.2.2 *Sektori i Çështjeve Ekonomike e Sociale*

- Koordonin zhvillimin e bisedimeve me BE-në për çështjet që lidhen me problemet Ekonomike e Sociale.
- **Analizon** të drejtat dhe detyrimet e palës shqiptare që rrjedhin nga MSA.
- Vlerëson, përpunon dhe **komunikon materialet** e përgatitura nga pala shqiptare në kuadër të bisedimeve
- Vlerëson, përpunon dhe **komunikon materialet** e përgatitura nga pala shqiptare në kuadër të Grupit Këshillimor të Punës, Grupit të Punës dhe takimeve të Komitetit të Përbashkët në mënyrë që të monitorohet zbatimi i reformave që lidhen me procesin e integritit Europian
- Monitoron zbatimin e reformave që rezultojnë nga MSA

4.2.3 *Sektori i Asistencës së Komunitetit*

- Përcakton prioritetet kombëtare dhe përgatit Programin Indikativ shumëvjeçar CARDS 2005 – 2006
- Bashkëpunon me institucionet e tjera për identifikimin dhe negocijimin e projekteve prioritarë për t'u financuar, bazuar në prioritetet sektoriale dhe në mbështetje të MSA.

- Përgatit për nënshkrim marëveshjet financiare që lidhen me asistencën komunitare
- Monitoron procedurat për nënshkrim të marëveshjeve financiare nga qeveria shqiptare dhe ratifikimin e tyre nga parlamenti i Shqipërisë
- Ndjek zbatimin e projekteve në kuadër të marëveshjeve financiare dhe përgatit raporte mbi rezultatet e programit CARDS

4.2.4 *Sektori i Analizave dhe Publikimeve*

- Ndjek zbatimin e politikave të BE-së
- Përgatit projekte që synojnë vlerësimin e impaktit të procesit të integritit European
- Identifikon prioritetet për studime analitike dhe informacion mbi donatorët potencialë që mund të financojnë ato
- Përgatit publikime të ndryshme në lidhje me çështjet Europiane me qëllim që të lehtësojë aksesin e publikut dhe marrjen e informacionit mbi procesin e integritit European
- **Zbaton Strategjinë** e informimit të publikut të aprovuar nga Ministria e Integritit European
- **Organizon aktivitete trainuese** mbi çështjet Europiane për administrimin publik dhe aktorët e tjerë në procesin e integritit European
- Ndjek krijimin e një baze të dhënash për projektet dhe studimet mbi çështjet Europiane me informacion statistikor të ndryshëm shqiptar dhe European
- Promovon bashkëpunimin me shoqërinë civile, universitetet dhe organizatat ndërkombëtare për çështjet me interes reciprok në kuadër të procesit të integritit European.

5.0 **Natyrë e problemeve të identifikuara**

Puna e kryer së fundmi në ministri ka identifikuar 2 probleme kryesore që kanë një impakt në funksionalitetin e Ministrisë:

Mbivendosja e kompetencave midis Drejtorisë së Integritit European të ministrisë dhe drejtorisë së Përafrimit të legjislacionit – mbivendosja shkaktohet për shkak të ngjashmërisë në përshkrimet e vendeve të punës dhe mungesës së një përkufizimi të qartë të fushave përkatëse.

Mungesa e koordinimit brenda ministrisë dhe midis Ministrisë së Integritit European dhe ministrive të linjës – ekzistonin mospërputhje në planet e punës së Drejtorive në lidhje më orientimin e politikave, përafrimin e legjislacionit dhe informimin e komunikimin me publikun.

Është vënë re që “për shkak të mungesës së një koordinimi eficient brenda MIE, midis MIE dhe ministrive të linjës, ka patur një mangësi serioze në konsolidimin e pozicioneve negociuese të Shqipërisë në lidhje me kërkesat Europiane si dhe një përdorim jo të mirë të burimeve njerëzore, i karakterizuar nga dublimi i punëve e si rrjedhim humbje energjish, kohe dhe burimesh.”

Të kthehemi tek përgjegjësitë specifike:

- 1 Roli i Drejtorisë së Përafrimit Ligjor duhet të jetë ai i sigurimit të inputeve për Planin Kombëtar, por jo ai i koordinimit të përgatitjes së tij, gjë e cila duhet të jetë përgjegjësi e të tjerëve.
- 2 Koordinimi apo monitorimi i grupeve të ngritura për zbatimin e planit duhet të jetë përgjegjësi e një njësie organizative të përcaktuar qartë, e ngarkuar me nxitjen e ministrive të linjës, e jo një njësi, përgjegjësia kryesore e së cilës është të sigurojë që ligjet janë përafuar me kompetencë e në mënyrë të logjikshme.
- 3 Vëmë re që ndër përgjegjësitë e Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit përfshihet edhe koordinimi i asistencës së huaj: përveç diskutimeve për rolin që duhet të luajë ministria në këtë drejtim, duhet të bëhet e qartë që kjo është një përgjegjësi e pazakontë për specialistët që merren me legjislacionin.
- 4 Në pikëpamjen tonë nuk është përgjegjësia e MIE të vendosë se cilat janë fushat prioritare për përafrim ligjor: besojmë që ministritë sektoriale duhet të jenë përgjegjëse për t'i identifikuar ato.
- 5 Komunikimi i informacionit është një fushë e specializuar. Nuk mendojmë që juristët nuk mund të kryejnë me kompetencë funksionet e komunikimit: por, sidoqoftë, duke ditur që ka persona të trajnuar posaçërisht për komunikim, atëherë propozojmë që kjo detyrë t'i caktohet një grupi të tillë, për të mos i marrë kohën stafit ligjor.
- 6 Ndërkohë që e shohim “bashkëpunimin” si një qasje të preferuar për kryerjen e shumë funksioneve, një përgjegjësi e përcaktuar për “të bashkërenduar” tenton të shpërndajë përgjegjësinë dhe raportimin – çdo përkrahim i pozicionit të punës duhet ta bëjë të qartë se kush është përgjegjës për arritjen e rezultateve.
- 7 Vëmë re që përgjegjësia që kemi identifikuar më sipër për sektorin e Çertifikimeve “përcakton teknikën dhe metodologjinë për përafrimin e legjislacionit”, dublon përgjegjësinë e identifikuar “koordinon dhe monitoron aktivitetet e ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera qendrore dhe siguron mjete metodologjike brenda kuadrit të grupeve speciale të punës për hartimin e legjislacionit të nevojshëm për të plotësuar detyrimet që rrjedhin nga MSA për Sektorin e Koordinimit.


- 8 Sektori i Çertifikimit është ngarkuar me “sigurimin e analizës krahasuese midis legjislacionit Shqiptar dhe *Acquis Communautaire*’. Sipas mendimit tonë, krahasimi duhet të jetë detyrim i një ministrie sektoriale.
- 9 Nuk shohim ndonjë kompetencë të veçantë që një sektor Çertifikimi duhet të sjellë për përgatitjen e pozicioneve negocijuese.
- 10 Përgjegjësinë që kemi identifikuar për Sektorin e Çertifikimit “kontribuon për përmirësimin e kualifikimit të juristëve, nëpunësve civilë dhe gjykatësve në lidhje me legjislacionin kombëtar që do të përafrohet me atë të BE-së” e shohim si një përgjegjësi të dubluar edhe nga Sektori i Koordinimit “kontribuon në zhvillimin e aftësive profesionale të juristëve, nëpunësve ligjorë dhe gjykatësve në lidhje me njohuritë e legjislacionit kombëtar të përafruar me legjislacionin e BE-së.”
- 11 Përsa i përket Sektorit të dokumentacionit European mendojmë që përgjegjësitë e tij dublojnë atë që mendojmë që mund të bëjë një Qendër e Dokumentacionit European. Ideja ka qënë që kur kjo qendër të ngrihej e të funksiononte, sektori nuk do të ekzistonte më ose do t'i transformonte funksionet e tij.
- 12 Në lidhje me sektorët përkatësisht përgjegjës për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme dhe për Çështjet Ekonomike e Sociale i shohim funksionet e tyre analitike dhe të komunikimit si funksione që mund të ofrohen nga një Sektor i analizave e publikimeve.
- 13 Përsa i përket Sektorit të Analizave e Publikimeve, është e paqartë se si ky rol do të ndryshojë nga ai i Sektorit të Dokumentacionit European në Drejtorinë e Përafrimit të Legjislacionit. Megjithatë, nuk dihet se çfarë trajnimi duhet bërë për të kryer funksionin e identifikuar “organizon aktivitete trajnuese mbi çështjet Europiane për administrimin publik dhe aktorët e tjerë të procesit të integritit European” dhe se pse trajnimi do të jetë pjesë e përgjegjësisë së një Sektori përgjegjës për botimin e informacionit.

Sa më sipër, duhet të jetë e qartë që kompetencat e kryqëzuara që ekzistonin në strukturën e mëparshme (dhe akoma po funksionojnë) kanë vepruar në drejtim të kundërt të kryerjes me eficiencë dhe me efektivitet të misionit të ministrisë.

Më poshtë do të shqyrtojmë strukturën e aprovuar së fundi (e treguar në faqen në vijim) dhe do të vlerësojmë organizimin funksional të saj.

Ministry for European Integration

Structure Existing as at March 2006



6.0 Vlerësimi i Strukturës Ekzistuese

Është e kuptueshme që një ndër përgjegjësitë e ministrit është të sigurojë që Shqipëria mban dhe zbaton një pozicion politik konsistent dhe të mirëkoordinuar në të gjitha aspektet e marrëdhënieve të veta me Bashkimin Europian. Për të arritur këtë, duhet që ministria të ketë disa kapacitete në nivel politik për të identifikuar dhe vlerësuar opsionet sektoriale, vlerësimet e ndikimit dhe pozicionet e politikave si dhe të bashkëpunojë me Ministrinë e linjës për të kryer studime për pozicionet, studime që do të merren në shqyrtim nga Këshilli i Ministrave.

Në shqyrtimin e strukturës së aprovuar, nuk është e qartë se ku duhet të vendosen këto kapacitete. Nga diskutimet e bëra kemi krijuar përshtypjen që zgjedhja e opsioneve sektoriale dhe pozicioneve politike si dhe përgatitja e studimeve të pozicioneve konsiderohet thjesht si një ndër përgjegjësitë e ndryshme që i caktohen drejtorëve në strukturën e re. Mendojmë që kjo do të shkaktojë mbingarkesë funksionale e cila do të rezultojë që disa apo të gjitha detyrat të mos kryhen siç duhet.

Në një kontekst të ngjashëm, siç u diskutua më parë, struktura formale e ministrisë kishte një drejtori për përafrimin e legjislacionit; funksionet e kësaj drejtorie tani janë transferuar dhe synohen të absorbohen nga dy drejtori përgjegjëse për koordinimin e punës në të gjitha ministritë. Ky mund të jetë një model i vlefshëm, duke supozuar që koordinatorët kanë njohuri të mjaftueshme për kërkesat e BE-së si dhe kualifikimet e nevojshme për të siguruar saktësinë dhe plotësimin e përafrimeve ligjore e gjithashtu eksperiencën, taktin dhe pjekurinë për të funksionuar me efektivitet në rolin e koordinimit. Megjithatë, është e vështirë të shihet se ekzistojnë njohuritë e aftësitë e nevojshme të kërkuara apo mund të ekzistojnë ato për një periudhë të gjatë kohe në një sens organizativ dinamik.


Jemi të ndërgjegjshëm që ndërsa Shqipëria ecën në rrugën drejt integritit, i duhet kushtuar një vëmendje e vazhdueshme cilësisë ligjore. Mendojmë që aftësia për të kryer analiza ligjore të sakta si dhe çertifikimi i legjislacionit nuk duhen kompromentuar. Në vend të ndarjes së Drejtorisë për Përafrimin e Legjislacionit në drejtori përgjegjëse për koordinimin e Ministrive Sektoriale do të propozonim forcimin e kësaj drejtorie.

6.1 Drejtoritë koordinuese

Një shqetësim tjetër është që Ministria në përpjekje për të zvogëluar strukturën e saj, ka vendosur shumë përgjegjësi mbi dy Drejtoritë koordinuese – Drejtësia dhe Punët e brendshme dhe Tregu i Brendshëm. Si shembull në lidhje me këtë, është fusha e përgjegjësisë e Drejtorisë së Tregut të Brendshëm. Për të treguar se sa e gjerë është gama e përgjegjësive që ato kërkojnë apo se cilët janë nën sektorët e tyre më të rëndësishëm, në faqen në vijim kemi treguar organigramën

e Drejtorisë së përgjithshme të BE-së për Shërbimet dhe Tregun e Brendshëm
(EU's DG of Internal Market & Services).

DG Internal Market & Services



* For BE, CY, FR, EL, HU, IE, LU, LT, LV, PT, PL, ES, UK
 ** For AT, CZ, DK, EE, FI, DE, IT, MT, NL, SE, SK, SI

16.02.2006

Siç e bën të qartë diagrama e mësipërme, në Ministrinë e Integritit Europian, drejtorja për Tregun e brendshëm nuk trajton vetëm çështjet e tregut të brendshëm – ajo përfshin një gamë të gjerë fushash dhe çështjesh sektoriale dhe ndërsektoriale. Në këndvështrimin tonë, të presësh që stafi të jetë në gjendje të kryejë koordinimin, raportimin dhe monitorimin (CRM); të ketë përgjegjësinë për të vërtetuar legjislacionin në se është përafuar siç duhet; të sigurojë që Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm janë të informuar siç duhet si dhe që delegacionet e misionet priten e shoqërohen; po ashtu të përgatisësh në nivelin e duhur dokumentat kombëtarë planifikues dhe studime mbi pozicionet, të gjitha këto janë një ngarkesë shumë e madhe për t'u kryer me kompetencë.

Propozojmë që të dy drejtoritë të bashkohen në një të vetme, por detyrat e tyre të ngushtohen vetëm në koordinimin, raportimin e monitorimin e ministrive për përpjekjet e tyre për pranimin në BE dhe kryerjen e analizave.

6.2 Drejtorja e proceseve institucionale të Koordinimit & Integritit

Drejtorja e proceseve institucionale të koordinimit dhe integritit është një "grumbull" i një numri funksionesh, shumica e të cilëve, plotësojnë njeri-tjetrin në varësi të detyrave që parashikohen të kryejnë. Megjithatë, ne kemi rezerva përse i përket vendosjes së një pjese të funksionalitetit të synuar.

6.2.1 Bashkëpunimi rajonal / Informimi i publikut

Njësia e Bashkëpunimit Rajonal kërkon krijimin dhe koordinimin e njësive të BE-së që do të operojnë në nivel rajonal apo nën rajonal për të informuar personat që merren me biznes dhe publikun e zakonshëm se çfarë do të thotë anëtarësimi në BE për ta. Këtë e shohim si një iniciativë pozitive e të mundshme. Megjithatë, aspektet e iniciativës nuk na janë bërë ende të qarta. Është akoma e paqartë se cili staf do të punojë – i ministrisë apo i zyrave rajonale; në cilat zyra rajonale do të vendosen p.sh., ato të Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Arsimit, etj; si do të koordinohet informacioni për t'u siguruar që mesazhet e tyre janë konsistentë me mesazhet që nxjerrin ministritë e linjës përgjegjëse për sektorë të ndryshëm; nga do të merren paratë për financimin e këtyre zyrave; cilat janë aftësitë e kërkuara për stafin në këto zyra rajonale të BE-së, etj. Detyra e parë e kësaj njësie do të jetë detajimi dhe zgjidhja e këtyre çështjeve dhe çështjeve të tjera që lidhen me to.

Në afat të shkurtër, përpara krijimit të rrjetit rajonal, Ministria duhet të përqendrohet në ngritjen e Njesisë së Dokumentacionit dhe Informimit të Publikut për të krijuar një qendër të Informimit mbi BE, të centralizuar, eficiente dhe që funksionon me efektivitet dhe më pas ta zgjerojë atë gjeografikisht. Kjo është strategjia që do të propozojmë.

6.2.2 Metodologjia e raportimit & Përkthimet

Nuk patëm rastin të shqyrtojmë ndonjë përshkrim të detajuar që të tregojë se çfarë do të bëjë kjo njësi. Sidoqoftë, këtu shtrohen dy çështje shumë të

ndryshme. E para, metodologjia e raportimit nuk na duket si një funksion i vazhdueshëm. Me aq sa jemi informuar, është përgatitur një metodologji raportimi e mbështetur në kompjuter e cila është financuar nga një iniciativë e BE-së. Nëqoftëse është kështu, mirëmbajtja e sistemit nga perspektiva e Teknologjisë së Informacionit është një detyrë e sektorit të ministrisë që merret me Teknologjinë e Informacionit brenda Drejtorisë së Shërbimeve të brendshme. Marrja e informacionit dhe e të rejave të fundit si dhe përgatitja e raporteve duhet të jetë përgjegjësi e drejtorive përgjegjëse për koordinimin, monitorimin dhe raportimin.

Përkthimet luajnë një rol të rëndësishëm në përafrimin e legjislacionit. Meqënëse shqiptarët do të punojnë në gjuhën e tyre, legjislacioni i BE-së dhe dokumentat e tjera që vijnë nga BE e që janë të rëndësishëm për procesin fillimisht duhet të përkthehen në shqip. Është shumë e qartë që nëqoftëse nuk i kushtohet kujdes përkthimit të dokumentave në shqip, do të humbasë saktësia e kuptimit. Po kështu, nëqoftëse dokumentat e përkthyer në gjuhët e punës të BE-së nuk janë përkthyer saktë, mund të krijohen përshtypje apo gjykime të gabuara për atë që synohet të shprehej. Prandaj është me rëndësi themelore që të krijohet një sistem, që të funksionojë për përkthimet dhe çertifikimin e tyre përpara se të fillojë puna dhe pasi të jenë përfunduar përafrimet.

Në analizën funksionale të Ministrisë së Drejtësisë të kryer në kuadër të këtij projekti, Konsulentët bënë vërejtjen e mëposhtme në lidhje me Ligjin Nr. 8678 të 14 majit 2001, të ndryshuar me Ligjin nr. 9112 të 24 korrikut 2003, “Mbi organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”. Raporti vuri në dukje që neni mbi përgjegjësitë përdor 17 lloje të ndryshme foljesh në trajtë veprorë apo shprehje foljore, megjithëse është e qartë që ministria ka më pak role funksionale. Në raportin e tij, konsulenti i referohet shembujve të tillë si “ndjek” kundrejt “ndjek e mbikqyr” kundrejt “ndjek, drejton e kontrollon” kundrejt “ndjek e mbështet” kundrejt “mbështet e merr pjesë” dhe “përgatit, ndjek, koordinon” kundrejt “ndjek e koordinon” kundrejt “koordinon” ose me shprehje të tilla si “ndjek e merr masa” kundrejt “realizon”. Konsulenti theksoi që në gjuhën shqipe disa terma ndoshta mund të jenë sinonime, e në këtë rast rekomandohet përdorimi i përsëritur i tyre për të shmangur keqkuptimet.

Ka disa opsione për të marrë shërbimet e kërkuara të përkthimit. Opsionet e menjëhershme do të ishin marrja nga jashtë; ministritë e ndryshme/apo institucionet mund të marrin përgjegjësi për dokumentat e fushës së tyre të kompetencave; ose përqëndrimi i përkthimeve.

Pavarësisht nga opsioni i zgjedhur për shërbimet e përkthimit, është e nevojshme dhe e rëndësishme të përgatitet një “fjalor” përkthimi me disa fjalë kryesore apo që ndeshen zakonisht. Gjithashtu, pavarësisht nga opsioni që zgjidhet duhet të ketë një zyrë të centralizuar që të çertifikojë përkthimet.

Preferenca jonë do të jetë që Ministria e Integritimit European të ketë përgjegjësinë për krijimin e “fjalorit” të përkthimit dhe për të çertifikuar përkthimet e dokumentave që shkojnë nga Shqipëria në BE e anasjelltas. Në rast se ministritë

dhe institucionet sektoriale do të kenë në dorë një “fjalor” përkthimi ata mund të kontraktjnë përkthyes nga jashtë institucioneve të tyre për të bërë përkthimet dhe t’i dorëzojnë këto përkthime tek Ministria e Integritit European për të marrë certifikimin e saj. Mendojmë që kjo qasje do të shërbejë për të minimizuar madhësinë e njësive me funksione mekanike brenda Shërbimit Civil.

6.3 Instrumentat e para-pranimit

Edhe më parë, nevoja për koordinimin e asistencës së donatorëve është shtruar në kontekstin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPS) i vendosur brenda Këshillit të Ministrave. Mendojmë që detyrat potenciale për Ministrinë e Integritit European si përgatitja e marëveshjeve financiare që lidhen me asistencën për komunitetet, bashkëpunimi me ministritë e linjës për të identifikuar projektet prioritare për financim dhe hartimi i programeve dhe fishave të projekteve në përputhje me kërkesat specifike të BE-së kërkon një ekspertizë që do të duhet shumë kohë të krijohet në shumicën e ministrive.

Në bazë të misionit të ministrisë, Koordinatorët e Ministrisë së Integritit European duhet të punojnë me ministri të ndryshme sektoriale për të hartuar plane ambicioze, por realiste për të plotësuar kërkesat e BE-së. Këto plane duhet të trajtojnë përafrimin e legjislacionit, krijimin e institucioneve të reja dhe strukturave që i shërbejnë shoqërisë, ngritjen e kapaciteteve institucionale, modifikimin e proceseve të brendshme rregullatore, zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme, etj.

Njohuritë e detajeve dhe kërkesave të asistencës së para pranimit janë shumë të specializuara dhe hartimi i programit dhe fishave të projekteve mund të jetë disi kërkues. Mendojmë që kjo justifikon një sektor me specialistë në këtë fushë. Por megjithatë, kur hartohen propozime specifike për asistencë, Ministria e Integritit European duhet të bashkëpunojë me Drejtorinë për Koordinimin e Strategjive dhe të Donatorëve në KM për të siguruar që propozimet përfshihen në programin e përgjithshëm të asistencës nga donatorët.

7.0 Modele të Strukturave Funktionale të vendeve të tjera

Vende të ndryshme të pranuar në BE adoptojnë një model për të organizuar përpjekjet e tyre – nuk ka një model “të provuar dhe që ka rezultuar i duhuri”. Disa vende si Bullgaria e ngritën strukturën e tyre organizative brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme. Disa vende si Malta, e ngritën këtë strukturë pranë zyrës së kryeministrit. Vende të tjera, përfshirë Shqipërinë kanë ngritur një ministri specifike për këtë qëllim. Do të shqyrtojmë shkurtimisht se si të tre vendet i kanë organizuar funksionet e tyre.

7.0.1 Malta

Me një popullsi prej 400,000 banorësh që jetojnë në dy ishuj të vegjël, Malta adoptoi një model minimalist. Përpjekjet për organizimin e procesit të pranimit u drejtuan nga një Sekretariat i drejtuar nga asistenti personal i Kryeministrit, i cili ishte si Kryetari i Grupit Kryesor Negociator. Detyrat e Sekretariatit ishin të:

- Jepte drejtim të përgjithshëm në përgatitjen e dokumentacionit teknik që përfshinte respektimin e afateve kohore dhe formateve standarde që i jepeshin ministrive;
- Finalizonte draftet e të gjithë dokumentacionit të hartuar nga ministrinë në lidhje me Drejtorinë e BE-së dhe Misionin e Maltës në BE për t'u marrë në shqyrtim nga Grupi Kryesor Negociator;
- Siguronte që pjesa tjetër e sistemit është plotësisht e informuar nëpërmjet Sekretarëve të Përhershëm përkatës mbi veprimet e nevojshme që dalin për zbatim si rezultat i negocijimeve;
- Mbikqyrte, në bashkëpunim me Misionin e Maltës në BE, të gjitha përgatitjet që lidhen me negocijimet individuale;
- Lidhej vazhdimisht me Misionin e Maltës në Bruksel, Drejtorinë e BE-së, Ministrinë e Linjës si dhe ekspertët teknikë që marrin pjesë në proces.
- Identifikonte problemet praktike që mund të dalin në çdo stad të procesit të para pranimit për t'u shqyrtuar nga Grupi Kryesor Negociator.

Sekretariati ishte strukturuar me tre koordinatorë drejtues (i brendshëm, i jashtëm dhe operativ). Katër analistë kërkimorë mbështesnin koordinatorët. Në Maltë, hartimi dhe/apo përafrimi i të gjithë legjislacionit është përgjegjësi e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Në portofolin e Ministrisë së Financave u krijua një njësi për të koordinuar aksesin dhe përdorimin e fondeve të pranimit. Në Maltë gjithashtu, qeveria krijoi një njësi të veçantë për të informuar publikun për çështjet që kishin lidhje me BE dhe afatet, kushtet e mundësitë që do të rezultonin nga pranimi.

Është e rëndësishme të theksojmë që kjo ishte struktura dhe burimet e krijuara gjatë dy viteve të fundit përpara se Malta të pranohej në BE në vitin 2004. Në atë kohë Malta ishte në një gjendje gatishmërie të përparuar.

7.0.2 Rumania

Me 22.3 milion banorë, Rumania zgjodhi ngritjen e një Ministrie për të drejtuar përpjekjet e saj për pranim. Ministria për Integrim European e Rumanisë ka 3 Sekretarë Shteti, një Sekretar të Përgjithshëm dhe një Asistent Sekretari të Përgjithshëm që mbështet drejtpërdrejt ministrin (ministri ka shumë përgjegjësi të tjera si: luftën kundër mashtrimeve dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar që në Shqipëri mbahen nga ministri të tjera).

Ministria ka 3 drejtorë të përgjithshëm dhe një Drejtor të nivelit të lartë, të cilët, nga ana e tyre, kanë në varësi 12 drejtori. Këto ndarje kryesore reflektojnë përgjegjësitë për “Vlerësim”, “Harmonizim”, “Bashkëpunim Territorial”, “Operacione Rajonale” dhe “Programi Phare”.

Gjithashtu, Ministria ka 10 drejtori të tjera, që kryesisht ofrojnë shërbime mbështetëse.

7.0.3 Kroacia

Popullsia e Kroacisë prej 4.5 milion banorësh është afërsisht sa ajo e Shqipërisë. Edhe Kroacia ka ngritur një Ministri për Integrimin European. Aktualisht, kjo ministri është absorbuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, por struktura ka mbetur ajo që ka qenë. Informacioni që na është dhënë tregon që ministria ka një staf që i kalon 125 persona të ndarë në mënyrën e mëposhtme:

Drejtorja për harmonizimin e Sistemit Ligjor, në varësi të saj janë *Drejtorja për analizën dhe harmonizimin e sistemit ligjor; dhe Drejtorja për monitorimin e procesit të harmonizimit të sistemit Ligjor*

Drejtorja për Strategjinë e Integritit, në varësi të saj është *Drejtorja për Koordinim dhe Monitorimin e Zbatimit dhe Drejtorja Analitike.*

Drejtorja për Koordinimin e Asistencës së BE-së dhe Programeve të Bashkëpunimit, në varësi të së cilës janë *Drejtorja për Programet Kombëtare; dhe Drejtorja për Programet Rajonale, Trans-kombëtare dhe të bashkëpunimit ndër-kufitar.*

Drejtorja për informim dhe edukim, në varësi të së cilës janë *Drejtorja për Informim; dhe Drejtorja për Edukim*

Qendra e Përkthimit, në varësi të së cilës janë *Drejtorja për përkthimin e Acquis në gjuhën kroate; dhe Drejtorja për përkthimin e legjislacionit kroat dhe të nevojave për përkthim të ministrisë.*

Drejtorja për çështjet organizative, të personelit dhe ato të përgjithshme si dhe aktivitetet në kompjuter.

Drejtorja për çështjet financiare dhe Kontabilitetin

Nëqoftëse modeli i Maltës mund të konsiderohet minimalist, modeli i Kroacisë, duke patur parasysh madhësinë e saj, mund të konsiderohet krejtësisht i kundërti i Maltës.

7.0.4 Konsiderata për Shqipërinë

Ashtu siç përmendëm më lart, nuk ka një model funksional organizativ ‘më të mirë’ që të kopjohet nga Shqipëria. Modeli minimalist i përdorur në Maltë funksionoi, sepse vendi kishte një shkallë të lartë gatishmërie dhe përgatitjet për pranim u koordinuan nga vetë Kryeministri. Modeli rumun mund të konsiderohet si “shumë i pasur” për një shtet në madhësinë e Shqipërisë: struktura e modelit kroat mund të konsiderohet e ngjashme me atë të Rumanisë, por në një shkallë shumë të ndryshme. Të gjitha vendet e treguara më sipër tentuan të ndanin përgjegjësitë në kategori kryesore, si më poshtë:

- Përafrimi i Legjislacionit
- Koordinimi /Strategjia e Integrimit
- Koordinimi i Programeve të Asistencës
- Informimi / Edukimi
- Bashkëpunimi rajonal

Ashtu si në të gjitha sipërmarrjet, jemi të opinionit që kur të ristrukturohet kjo ministri, Shqipëria mund të preferojë të nisë nga një madhësi e vogël dhe të rritet për të plotësuar kërkesat voluminoze dhe komplekse. Megjithatë, është e këshillueshme të reflektohen këto ndarje funksionale të përgjithshme.

8.0 Struktura funksionale e propozuar

Ministria e Integritit European nuk është si ministritë e tjera të linjës në kuptimin që ajo nuk është një organ politikëbërës; as rregullator e as nuk ka përgjegjësi për ofrim shërbimesh. Politika e qeverisë për anëtarësimin në Bashkimin European është e formuluar. Herë pas here mund të shtrohet nevoja për ta përshtatur qëndrimin politik, por kjo nuk është një çështje që mund të vendoset vetëm nga një ministri. Po kështu, ndërkohë që kjo ministri ka një rol koordinues e mbështetës për të luajtur, ajo nuk mund të shihet as si rregullator as si ofrues shërbimesh në kuptimin që këto janë aspekte të qeverisë që normalisht është e drejtuar nga sektori privat. Përveç funksionit të informimit publik, roli i Ministrisë së Integritit European është i brendshëm për qeverinë.

Në strukturën funksionale që jepet në faqen e fundit të këtij raporti, jemi përpjekur të rendisim e qartësojmë funksionet që duhet të kryejë ministria për të siguruar që Shqipëria plotëson kërkesat e Bashkimit European në një mënyrë eficiente.

8.1 Drejtoria e Koordinimit dhe Analizës

Propozimi ynë është që të formohet një drejtori për të kryer funksionet e koordinimit, raportimit dhe monitorimit (CRM), të kryejë analiza dhe të formulojë propozime strategjike në lidhje me takimet dhe negocijimet e ardhshme. Propozojmë që drejtoria të ketë dy sektorë: një që do të merret me funksionet CRM; tjetri do të kryejë vlerësimet e çështjeve dhe zhvillimin strategjik. Sektori i parë do të jetë relativisht i madh, por meqënëse problemet që ndikojnë progresin mund të jenë të zakonshme në të ardhmen, nuk mendojmë që mund të shkaktohet ndonjë problem menaxhimi.

Drejtorja do të ketë detyrat e mëposhtme:

8.1.1 Koordinimi

KOORD 1 Koordinimi i të gjitha mbledhjeve, programeve dhe aktiviteteve të grupeve të punës që lidhen me integrimin European dhe sigurojnë që ndiqen veprimet e nevojshme.

KOORD 2 Lidhjet me Përfaqësinë shqiptare në Bashkimin European dhe me zyrtarë të komisioneve përgjegjës për procesin e pranimit të Shqipërisë për të identifikuar takimet me përfaqësuesit e qeverisë dhe Komisionin e BE-së, Presidencën, Parlamentin European dhe shtetet anëtare, të cilat do të jenë të rëndësishme për negocijimet për pranim.

KOORD 3 Mbajtja e një kalendari të vazhdueshëm mbi të gjitha aktivitetet dhe takimet që lidhen me procesin e pranimit (në Shqipëri dhe jashtë saj).

KOORD 4 Ngritja, mbajtja dhe bashkeveprimi me ministritë e linjës e një baze të dhënash qendrore me individët dhe kontaktet kryesore të përfshirë në procesin e pranimit (brenda qeverisë, Komisioni dhe shtetet anëtare).

KOORD 5 Menaxhimi i mirëmbajtjes së një sistemi efficient të skedimit të dokumentave (në formë kompjuterike dhe në letër) brenda ministrisë.

8.1.2 Raportimi

RAPORT 1 Krijimi dhe ndjekja e një procesi aprovimi për të gjithë “status reports”, “position papers” dhe dokumentacionin që lidhet me to.

RAPORT 2 Lidhja me ministritë e linjës, përfaqësinë shqiptare në Bashkimin Europian dhe Komisionin Europian gjatë përgatitjes së “status reports”, “position papers” dhe dokumentacionin që lidhet me to për të siguruar që afatet respektohen dhe përmbajtja dhe paraqitja e përgjithshme i plotëson standardet e cilësisë.

RAPORT 3 Përpilimi i raporteve javore dhe mujore për Sekretarin e Përgjithshëm mbi aspektet e përafrimit dhe proceset e përgatitjes.

RAPORT 4 Mbajtja dhe përditësimi i TAIEX dhe të dhënave të tjera bazë që përdoren për raportet

RAPORT 5 Përgatitja e raporteve mbi rezultatet e projekteve që financohen me programin CARDS

8.1.3 Monitorimi

MONI 1 Monitorimi i performancës së ministrive të linjës për të arritur pikësynimet e caktuara në Planin Kombëtar si përsa i përket legjislacionit ashtu edhe për ngritjen e kapaciteteve dhe atë institucionale.

MONI 2 Monitorimi i përgatitjes së studimeve të vlerësimeve të impaktit dhe këshillimi i Sekretarit të Përgjithshëm mbi progresin dhe gjetjet e studimeve të tilla.

MONI 3 Hartimi dhe mbajtja e planeve të projekteve për angazhimet, detyrat dhe nismat nga ministritë dhe njësitë sektoriale për t’u aftësuar për vlerësimin e progresit të bërë.

MONI 4 Sigurimi që ministritë hartojnë plane reformimi të plota të cilat kërkojnë përafrimin e legjislacionit, ngritjen e kapaciteteve, asistencën teknike, investimet në infrastrukturë, etj., dhe që të gjithë këto elementë trajtohen në kohë e me kompetencë në realizimin e këtyre planeve.

MONI 5 Monitorimi i procedurave për nënshkrimin e marrëveshjeve financiare nga qeveria shqiptare dhe ratifikimi i tyre nga Parlamenti i Shqipërisë.

8.1.4 Analiza

Përveç aktiviteteve të mësipërme, ndërsa ministri shërben si personi kryesor në diskutimet me BE-në, parashikohet nevoja për aftësi analitike që do të shërbejnë për të asistuar ministrin në marrjen e pozicioneve dhe kryerjen e marëveshjeve që do të aprovohen nga Këshilli i Ministrave dhe për t'u përdorur gjatë procesit të diskutimeve me BE-në.

Dihet që ministrinë e linjës janë, ose duhet të jenë, ekspertët mbi çështjet sektoriale. Megjithatë, kemi mendimin që Ministria e Integrimit European duhet të ketë kapacitete të afta për të qenë në gjendje të japin informacione që marrin në konsideratë implikimet financiare, ekonomike, sociale, legjislative, institucionale dhe të opinionit publik, të para në kompleksitetin e tyre nga një ministri që ka një këndvështrim jo pasionant mbi vetë çështjet. Gjithashtu, ministria duhet të ketë kapacitetet për të vëzhguar progresin dhe problemet e vendeve të tjera që aspirojnë të bëhen shtete anëtare të BE-së. Përgjegjësitë përkatëse i perceptojmë si më poshtë:

- ANAL 1 Analiza e përmbajtjes teknike dhe ligjore të dokumentacionit që lidhet me pranimin dhe, sipas kërkesës, këshillimi i Sekretarit të Përgjithshëm / Ministrisë mbi ndonjë çështje që del nga analiza të tilla.
- ANAL 2 Përgatitja / bashkimi i informacionit për materialet prezantuese / informuese, sipas kërkesës, për të siguruar konsistencë dhe cilësi.
- ANAL 3 Hartimi i informacioneve për Ambasadorët shqiptarë në Shtetet anëtare të BE-së dhe vendeve të tjera në një mënyrë të strukturuar dhe të vazhdueshme.
- ANAL 4 Përgatitja e projektit përfundimtar të planeve kombëtare të punës dhe programeve të orientuara drejt plotësimit të kërkesave të anëtarësimit në Bashkimin European.
- ANAL 5 Analiza e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga MSA për palën shqiptare si dhe nga marëveshje të tjera të rëndësishme apo që pasojnë atë.
- ANAL 6 Kryerja e studimeve analitike që marrin në konsideratë se kur është në interesin më të mirë të Shqipërisë për të mbajtur një pozicion negocijues e jo atë të të bindurit, për çfarë duhet bërë marëveshje dhe si mund të realizohet kjo marëveshje.
- ANAL 7 Përgatit projektet që synojnë vlerësimin e impaktit të procesit të integrimit European.

8.2 Drejtoria e Asistencës për pranimin & informimit të komunitetit

Në këtë drejtori të propozuar, përgjegjësitë funksionale për asistencën për pranim do t'i propozonim të bashkoheshin me ato për informimin e komunitetit. Lidhja ka të bëjë me aspektin rajonal të një pjese të rëndësishme të financimit të

vlefshëm për pranim dhe nevojës për të informuar përfituesit e mundshëm në nivel lokal dhe çfarë duhet bërë për t'u kualifikuar për të.

8.2.1 Asistenca e pranimit

Programi i BE-së për asistencën, Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim (CARDS) mbështet vendet e Europës juglindore në ndjekjen dhe realizimin e objektivave të tyre nën marëveshjen e MSA. Programi CARDS ka katër objektiva kryesore:

- 1 rindërtimi, stabilizimi demokratik, ribashkimi dhe kthimi i refugjatëve;
- 2 zhvillimi institucional dhe legjislativ, përfshirë harmonizimin me normat dhe modelet e BE-së për të fuqizuar demokracinë dhe zbatimin e ligjit, shoqërinë civile dhe median si dhe funksionimin e një ekonomie të tregut të lirë;
- 3 zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik e social, përfshirë edhe reformën strukturore;
- 4 promovimi i marëdhënieve më të ngushta dhe bashkëpunimit rajonal ndërmjet vendeve dhe midis tyre, BE-së dhe vendeve kandidate të Europës Qendrore.

Brenda këtyre katër objektivave kryesore, sektorët prioritarë për asistencën e CARDS për Shqipërinë janë :

- Lufta kundër krimit, mashtrimeve dhe korrupsionit
- Forcimi i administratës publike
- Mbështetja e tregtisë, arsimit dhe transportit
- Monitorimi i ndotjes dhe planifikimit të zhvillimit urban
- Reformimi i sistemit elektoral

Qëllimi i programit është të përmirësohet cilësia e jetës në zonat rurale dhe të ngrihet ndërgjegjësimi i komunitetit nëpërmjet rehabilitimit të infrastrukturës lokale dhe përfshirjes së komuniteteve lokale në vendimmarrje. Në këtë kontekst e shohim përfshirjen e këtyre përgjegjësive funksionale në një Drejtori që është përgjegjëse si për shpërndarjen e informacionit ashtu edhe për bashkëpunimin rajonal:

PRANIMI 1 Vendosja e prioriteteve kombëtare dhe përgatitja e Programit CARDS indikativ shumëvjeçar

PRANIMI 2 Bashkëpunimi me institucione të tjera për identifikimin dhe negocijimin e projekteve prioritare për financim bazuar në prioritetet sektoriale.

PRANIMI 3 Përgatitja e programit dhe fishave të projektit që lidhen me asistencën për komunitetin, të gatshme për nënshkrim

8.2.2 Shpërndarja e informacionit

Përparimi i një shteti drejt pranimit në Bashkimin European mund të perceptohet nga publiku ose si një rrezik ose si një mundësi: në këto rrethana nevojitet shpërndarja e informacionit shpjegues që merr parasysh nevojat e çdo grupi interesi. Ministria është e vetëdijshme që ka një rol të rëndësishëm për dhënien e një informacioni më të madh mbi Bashkimin European. Ajo duhet të grumbullojë dhe organizojë informacionin që lidhet me BE-në, të ngrrejë një qendër informimi dhe të japë për publikun e gjerë, bizneset dhe grupe të tjera interesi një informacion të përditësuar. Më pas (por jo shumë vonë), kjo qendër do të shërbejë si një pikë referimi për të gjithë ata që kërkojnë informacion të përgjithshëm në lidhje me BE-në, marrëdhëniet Shqipëri-BE dhe, ose drejtpërdrejt ose nëpërmjet një njësie të pavarur të ngritur për këtë qëllim, ajo duhet të pranojë kërkesa në lidhje me informacionin e specializuar mbi çështjet që lidhen me BE-në dhe t'i trajtojë ato siç duhet.

Përgjegjësitë funksionale do të jenë si më poshtë:

- INFO 1 Koordinimi i përgatitjeve të kërkuara për ndonjë aktivitet që përfshin median e lajmeve, përfshirë edhe përgatitjen e informacioneve për median;
- INFO 2 Përgatitja e broshurave informuese, raporteve dhe botimeve mbi çështjet e integritit European për të plotësuar kërkesat e publikut të gjerë, konsumatorëve dhe bizneseve;
- INFO 3 Krijimi i një rrjeti qendrash rajonale për informacionin mbi BE-në dhe sigurimi që informacioni i siguruar nga këto qendra është i saktë;
- INFO 4 Krijimi dhe mbajtja e një biblioteke për BE-në mbi çështjet e përgjithshme dhe specifike si dhe ato ligjore;
- INFO 5 Organizimi i konsultimeve publike në lidhje me procesin e integritit European;
- INFO 6 Zbatimi i Strategjisë së Informimit Publik të aprovuar nga Ministria e Integritit European.

8.2.3 Bashkëpunimi rajonal

Zgjerimi i bashkëpunimit rajonal është një ndër objektivat kryesore të marra në Axhendën e Selanikut për fuqizimin e procesit të stabilizimit dhe asocijimit. Në një takim në Qershor të vitit 2003, Shqipëria u angazhua të krijojë e zhvillojë bashkëpunimin rajonal dhe të promovojë një numër objektivash specifike në lidhje me tregtinë e lirë rajonale, krijimin e tregjeve rajonale për elektricitetin e gazin, zhvillimin e transportit, infrastrukturave të energjisë dhe telekomunikacioneve, mjedisit, teknologjisë dhe zhvillimit kërkimor, bashkëpunimit ndërkufitar e parlamentar, etj. Mendojmë që funksionet e kësaj njësie të ndjekin linjat e mëposhtme:

- BA_RA1 Puna me Drejtoritë e Politikave të ministrive që kanë përgjegjësi përkatësisht për ekonominë, transportet, energjinë, komunikacionin, lëvizjet ndërkufitare të mallrave, njerëzve dhe shërbimeve, sigurinë, etj., për të përcaktuar objektivat rajonale të bashkëpunimit, iniciativat, masat dhe synimet e performancës dhe për të siguruar ekzistencën e një mjedisi pune me qëllim përparimin e këtyre iniciativave;
- BA_RA2 Përcaktimi i indikatorëve bazë si një parakusht për të ditur se si po ecën bashkëpunimi rajonal dhe përditësimi periodik i tyre;
- BA_RA3 Hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për arritjen e bashkëpunimit rajonal dhe përditësimi periodik i saj;
- BA_RA4 Me pjesëmarrjen e Ministrisë së Jashtme, ndjek korrespondencën dhe bashkëpunimin me fqinjët rajonalë për të përcaktuar rrugët dhe mënyrat për ndarjen dhe kontrollin e burimeve për të maksimizuar progresin duke shpërndarë kostot.

Burimet njerëzore të njësisë do të trajtojnë fushat që kanë lidhje me:

- Energjinë dhe ekonominë
- Transportin dhe komunikacionin
- Çështjet e sigurisë dhe të punëve të brendshme

8.3 Drejtoria e çertifikimeve

Brenda Drejtorisë së propozuar të çertifikimeve, propozojmë të vendosim përgjegjësinë për çertifikimin e përkthimeve të dokumentave me çertifikimin e përafrimit të legjislacionit. I shohim këto të lidhura ngushtë sepse shumica e dokumentave shprehin ide, politika dhe deklarata të tjera që do të kenë kuptim ligjor. Përgjegjësitë përkatëse do të jenë si më poshtë:

8.3.1 Çertifikimi i legjislacionit

- ÇERT 1 Krijimi dhe shpërndarja në ministritë e linjës e një ‘fjalori’ terminologjik dhe foljesh për t’u përdorur gjerësisht në hartimin e legjislacionit.
- ÇERT 2 Në lidhje me të gjithë legjislacionin që paraqitet për çertifikim, të sigurojë që ministritë e linjës bëjnë një krahasim nen për nen me legjislacionin, direktivat dhe rregullat e BE-së si dhe çfarë është adoptuar plotësisht, pjesërisht apo nuk është pranuar – duke paraqitur edhe arsyet me qëllim që të bëhet arsyetimi dhe nëqoftëse është e nevojshme të anulohet nga autoriteti i duhur.
- ÇERT 3 Shqyrtimi dhe çertifikimi (apo kthimi tek organi inicues për amendim) i të gjithë legjislacionit që është përafruar me atë të Bashkimit Europian.

8.3.2 Çertifikimi i përkthimeve

- PWRKTH 1 Koordinon punën dhe redakton përkthimin e dokumentave brenda procesit të përafrimit të legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit Europian
- PWRKTH 2 Bën përkthimin e legjislacionit shqiptar në një ndër gjuhët zyrtare të BE-së në fushat prioritare dhe/ose me kërkesë të strukturave përkatëse të BE-së dhe harton standardet për to;
- PWRKTH 3 Jep mbështetje terminologjike për procesin e përkthimit;

8.4 Shërbimet mbështetëse

Shërbimet mbështetëse ndjekin funksionet normale si për çdo ministri. Tërheqim vëmendjen që nuk kemi parashikuar një funksion për auditimin e brendshëm. Sipas pikëpamjes sonë, transaksionet e kësaj ministrie nuk janë aq të shumta sa të kërkojnë një funksion të përhershëm të auditimit të brendshëm. Herë pas here, Sekretari i Përgjithshëm / Ministri mund të kërkojë një ministri tjetër (mbase atë të Financës) për të dhënë shërbimet në këtë fushë.

9.0 Në lidhje me Ministrinë e Linjës

Në kontekstin e gjithë këtij projekti në të cilin kemi analizuar ministrinë e qeverisë shqiptare, kemi reflektuar pikëpamjen tonë që është e papërshtatshme që çdo ministri të ketë në strukturën e vet një Drejtori të Integritimit Europian. Arsyeja për këtë është që në ato ministri ku ekziston një drejtori e tillë, drejtorinë e tjera të ministrisë tentojnë të heqin dorë nga përgjegjësia për t'u njohur me kërkesat e BE-së. Pikëpamja jonë u përforcua nga një analizë e kryer nga një konsulent, në kuadër të një projekti tjetër, për një nga ministrinë e linjës në të cilën ishte theksuar që ekzistenca apo krijimi i një njësie për BE-në 'do të ishte plotësisht joproduktiv, sepse do t'i izolonte çështjet e BE-së si të rëndësishme vetëm për këtë njësi. Axhenda e pranimin në BE do të përshkojë çdo gjë që bën ministria. - - - Aktualisht, axhenda e pranimin perceptohet si vetëm e lidhur me përafrimin e ligjeve dhe si pasojë punë vetëm e drejtorisë juridike”.

Besojmë që çdo nëpunës i lartë në qeveri duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe duhet të punojë për plotësimin e kërkesave për integritimin Europian. Ndjejmë që aty ku ekziston një Drejtori e Integritimit Europian brenda një ministrie, kjo drejtori mund të bëhet pengesë për rrjedhjen e informacionit në dhe nga drejtorinë e tjera. Besojmë që nëqoftëse të gjithë drejtorët janë të ndërgjegjshëm apo veprojnë në bazë të përgjegjësive të tyre për integritimin Europian, një Drejtori për Integritimin Europian është e tepërt dhe përbën një shpenzim burimesh. Së fundi, mendojmë që në rast se Drejtorët nuk janë të ndërgjegjshëm dhe nuk veprojnë në bazë të përgjegjësive të tyre për integritimin Europian, atëhere Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrë masa për rregullimin e kësaj situate.

Sipas pikëpamjes sonë, Sekretari i Përgjithshëm duhet të menaxhojë ekipin e tij/saj dhe të koordinojë rrjedhjen e informacionit në një mënyrë të tillë që ku

është e nevojshme të merret një qëndrim kolegjal për zgjidhjen e çështjeve. Është e kuptueshme që edhe një Sekretar i Përgjithshëm tërësisht kompetent është një person i vetëm dhe që pavarësisht nga kërkesat periodike për udhëtime, roli i tij kërkon menaxhimin e stafit të lartë dhe informimin i vazhdueshëm e në kohë të ministrit. Kjo e bën rolin e SP shumë kërkuar. Për këtë arsye, propozojmë që Sekretari i Përgjithshëm në ministritë e linjës të lejohet të ketë një sekretariat të vogël. Përgjegjësia e këtij sekretariati nuk do të lidhet vetëm me çështjet që kanë të bëjnë me integrimin Europian, e ai nuk është menduar si një kanal komunikimi midis ministrisë dhe ministrive të tjera, e as si një njësi me autoritetin për të rekomanduar prioritetet dhe alokimin e burimeve.

Vlerësojmë që Sekretari i Përgjithshëm është pika e hyrjes së informacionit në ministri dhe e daljes së tij nga ministria. Sipas këndvështrimit tonë, ky është çelësi i pasjes së një Sekretari të Përgjithshëm të informuar plotësisht për çështjet dhe punët e përditshme. Sekretari i Përgjithshëm duhet t'i drejtojë problemet dhe informacionin tek Drejtorët/drejtoritë e ndryshme. Problemet duhet të përputhen me përgjegjësitë specifike që ka drejtorja dhe të jenë konsistente me çështjet e menaxhimit që diskutohen gjatë mbledhjeve të stafit menaxhues.

Sekretariati i propozuar do të jetë një njësi joekzekutive që vepron në mbështetje të Sekretarit të Përgjithshëm. Një anëtar i Sekretariatit do të marrë pjesë në mbledhjet e stafit menaxhues për të mbajtur shënime diskutimit e bëra dhe në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të ndjekë detyrat e lëna për t'u siguruar që ato ndiqen në kohë. Kur dokumentat dërgohen tek Sekretari i Përgjithshëm nga Drejtoritë, ato shqyrtohen fillimisht nga sekretariati për t'u siguruar që problemet janë trajtuar me kompetencë dhe ku ka qenë e nevojshme janë diskutuar midis drejtorive dhe kontributet e tyre janë reflektuar në dokumenta. Ky funksion aplikohet në të njëjtën mënyrë edhe për çështjet që lidhen me integrimin Europian, planifikimin e SKZHEs, kërkesat e asistencës së donatorëve, etj. Gjithashtu, mendojmë që ky sekretariat do të punojë për të asistuar Sekretarin e Përgjithshëm në përcaktimin e objektivave strategjike, masave dhe synimeve të performancës për secilin drejtor në varësi dhe në emër të Sekretarit të Përgjithshëm, sekretariati do të monitorojë performancën e drejtorive. Ashtu siç u theksua, jemi të mendimit që sekretariati nuk do të ketë autoritet ekzekutiv – por ai do të sjellë problemet e shqetësimet në vëmendje të Sekretarit të përgjithshëm, përgjegjësia e të cilit është të marrë menjëherë masat për përmirësimin e gjendjes.

Nuk kemi trajtuar çështjen e madhësisë së sekretariateve të propozuara, përveç faktit që kemi thënë që ato duhet të jenë njësi të vogla në përputhje me kompleksitetin e çështjeve, vëllimin e dokumentacionit të trajtuar dhe madhësinë e përgjithshme të përgjegjësive të ministrisë. Në disa ministri, Sekretariati mund të jetë vetëm një person, në raste të tjera mund të jenë 2 ose 3 persona.

10.0 Shënime përmbyllës

Dimë që Ministria ka një strukturë të aprovuar dhe që në disa aspekte, propozimet që po japim në këtë raport janë të ndryshme nga kjo strukturë. Ne

nuk mendojmë që struktura e aprovuar për ministrinë nuk është e saktë, por ndoshta ajo është shumë ambicioze bazuar në kompleksitetin dhe vëllimin e problemeve, nivelin e sofistikimit menaxherial brenda sistemit si një i tërë, kufizimet në staf dhe kualifikime, kulturën e trashëguar të punës, mungesën e procedurave të standardizuara dhe kufizimet buxhetore. Argumentojmë që funksionet duhet të shpërndahen më shumë nëqoftëse duhet të realizohen me efektivitet. Duke thënë këtë, e kuptojmë që struktura më e mirë për një organizatë është ajo strukturë që funksionon. Nëqoftëse Ministria mendon që po realizon siç duhet, apo mund të realizojë, misionin e saj nëpërmjet strukturës së aprovuar, natyrisht që duhet të vazhdojë me atë strukturë. Megjithatë, nëqoftëse do të ketë pakënaqësira për performancën e ministrisë me këtë strukturë, atëhere ajo duhet të marrë në konsideratë grumbullimin e funksioneve dhe adoptimin e strukturës që propozojmë ne.

Ministry for European Integration

Proposed Functional Structure

